



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

A-A
R
2.04/15

Nr 121... Prot

Tiranë, më 18.01.2015

Komis. të Eham,

Lënda: Dërgohet dekreti i Presidentit të Republikës

KUVENDIT

TIRANË

Të nderuar,

Bashkëlidhur, Ju dërgojmë dekretin e Presidentit të Republikës me nr. 8899 datë 16.01.2015 "Për kthimin të ligjit nr. 181/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë".

Ju faleminderit!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

FLORJAN NURI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

D E K R E T

P Ë R

KTHIMIN E LIGJIT NR. 181/2014 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9665, DATË 18.12.2006, “PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE, BORXHIN SHTETËROR DHE GARANCITË SHTETËRORE TË HUAS NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”


Në mbështetje të nenit 85, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,


D e k r e t o j

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 181/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”.

Nr. Dekretit 8899
Tiranë, më 16.01.2015

PRESIDENTI I REPUBLIKËS


BUJAR NISHANI



Arsyet e kthimit të ligjit nr. 181/2014 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar deputetë,

Në seancën plenare të datës 24 Dhjetor 2014, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.181/2014 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj është paraqitur për shpallje më datë 29 dhjetor 2014.

Këshilli i Ministrave në relacionin e projektligjit në fjalë ka vlerësuar se përmes ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, synohet: (i) të përmirësohet kuadri ligjor i huamarrjes shtetërore, duke e harmonizuar këtë veprimtari me praktikën më të mira të tregjeve ndërkombëtare të parasë; (ii) të përmirësohet qartësia ligjore në standardet e kërkuara nga tregjet ndërkombëtare me qëllim që shtetit shqiptar t’i jepet një qasje në tregjet ndërkombëtare të parasë, duke synuar në uljen e kostos së huamarrjes shtetërore; (iii) të qartësohen procedurat, si në rastin e huamarrjes nëpërmjet instrumenteve të së drejtës private, ashtu edhe në rastin kur kjo realizohet ndërmjet dy subjekteve sovrane.

Referuar Relacionit të Projekt-ligjit përmes këtyre ndryshimeve lehtësohet veprimtaria e ekzekutivit pa çenuar të drejtat e Kuvendit të Shqipërisë, duke pretenduar se garantohet në këtë mënyrë edhe zbatimi i parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Përmes këtij ligji, duke realizuar edhe një interpretim të neneve 156 dhe 159 të Kushtetutës është autorizuar në mënyrë absolute Ministri i Financave në marrjen e borxhit të huaj dhe të brendshëm.

Duke bërë një interpretim të neneve 121 dhe 156 të Kushtetutës është bërë ndarja e marrëveshjeve të huave shtetërore në marrëveshje ndërkombëtare me subjekte private dhe shtete/organizata ndërkombëtare.

Është zgjeruar qëllimi për marrjen e borxhit, duke përfshirë edhe mbulimin e projekteve të miratuara nga Kuvendi për pushtetin vendor apo subjekte të tjera.

Është ndryshuar procedura e përzgjedhjes së subjekteve private kreditore, nga ajo ‘me prokurim publik’ në atë ‘me vendim të Këshillit të Ministrave’. Gjithashtu, është parashikuar përjashtimi nga procedurat e prokurimit publik edhe të përzgjedhjes së këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të borxhit shtetëror.

Në bindje të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të Kushtetutës kam vlerësuar se ky ligj i duhet kthyer për rishqyrtim Kuvendit mbështetur në arsyet dhe argumentet e mëposhtme.

Së Pari: Përmes këtij ligj Këshilli i Ministrave pretendon se synohet të përmirësohet kuadri ligjor i huamarrjes shtetërore, duke e harmonizuar këtë veprimtari me praktikën më të mira të tregjeve ndërkombëtare të parasë dhe me qëllim uljen e kostos së huamarrjes shtetërore. Gjithashtu, pretendohet të saktësohen garancitë ligjore përsa i përket ligjit të zbatueshëm apo mënyrës së zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me palët e treta në kuadër të marrëveshjes së borxhit si dhe të përqaset ligji për huamarrjen shtetërore me dispozitat e Kushtetutës, ku Ministri i Financave të jetë fleksibël në marrjen e borxhit referuar kufirit të borxhit të miratuar nga ana e Kuvendit.

Në kuptim të nenit 156 të Kushtetutës, Shteti mund të marrë e të garantojë hua dhe kredi financiare nga subjekte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke përfshirë këtu edhe Shtetet apo organizatat ndërkombëtare dhe në çdo rast Shteti mbetet i detyruar për sa ka rënë dakord në marrëveshjen e realizuar. ***Por, Kushtetuta ka bërë të qartë se borxhi qoftë i brendshëm apo i huaj do të merret kur të autorizohet me ligj nga Kuvendi.***

Ligji nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë" ka si objekt rregullimin e emetimit dhe menaxhimit të huamarrjes shtetërore, të borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huas. Në nenin 7 të këtij ligji është përcaktuar qartë qëllimi i marrjes së borxhit nga Këshilli i Ministrave përmes Ministrit të Financave.

Ndërsa, referuar nenit 159 të Kushtetutës, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" ka si objekt të rregullojë sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit, ku në nenin 57 të këtij ligji përcaktohet 'Autoriteti për të marrë hua' që është Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Financave dhe në nenin 58 të tij përcaktohen 'Kufijtë e borxhit publik'.

Ligji nr. 181/2014, i cili ndryshon ligjin ekzistues nr. 9665/2006 nuk arrin të paraqesë qartë se cilat standarte përkatëse të tregjeve ndërkombëtare në menaxhimin e huas shtetërore po adreson dhe sesi këto standarte do të zbatohen në kontekstin e tregut shqiptar. Kjo është vënë në dukje edhe nga Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut në Raportin në lidhje me projekt-ligjin. Në asnjë rast nuk është bërë përqasja me shtete të tjera të BE-së apo me organizata ndërkombëtare që operojnë në këtë fushë.

Duket se qëllimi i vetëm ka qenë t'i jepet sa më tepër fleksibilitet Ministrit të Financave në marrjen e borxhit, në përzgjedhjen e subjekteve kreditore private, në përzgjedhjen e këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të borxhit shtetëror, duke shmangur procedurat e prokurimit të cilat janë të referuara në ligjin nr. 9643/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Së Dyti: Problemi që ngrihet në nivel kushtetues ka lidhje me interpretimin e nenit 156 të Kushtetutës dhe problemin që ka Ministri i Financave në detyrimin e ratifikimit në Parlament të ***'marrëveshjeve ndërkombëtare'*** me subjekte private.

Propozuesit e ligjit pretendojnë se ***'Autorizimi që organet e ekzekutivit duhet të marrin në kuptim të neneve 156 dhe 159 të Kushtetutës, realizohen nëpërmjet rregullimeve ligjore, përkatësisht, në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe në ndryshimet e propozuara në këtë ligj'***. Pra, propozuesit e ligjit kanë ezauruar detyrimin kushtetues të autorizimit nga ana e Kuvendit për Ministrin e Financave në marrjen e borxhit me faktin se 'kufiri i borxhit' vendoset në ligjin për buxhetin që miratohet çdo vit. Dhe i vetmi problem të cilin shohin se duhet të rregullohet përmes ligjit është rregullimi i rasteve kur borxhi merret nga subjekte private të huaja.

Në fakt, neni 156 i Kushtetutës nuk mund të lexohet kaq përciptazi. Është e vërtetë që ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" ka përcaktuar Autoritetin për marrjen e borxhit dhe kufirin e borxhit, por kjo ama nuk do të thotë se togfjalëshi ***'kur autorizohet me ligj'*** ka patur si qëllim të referojë në ligjin e buxhetit në të cilin vendoset edhe kufiri i borxhit. Propozuesit e ligjit flasin për parimin e balancës dhe ndarjes së pushteteve mes legjislativit dhe ekzekutivit, por nga ana tjetër referuar mënyrës se si e interpretojnë nenin 156 të Kushtetutës, duket se Kuvendi ka bërë një delegim absolut të tagrave të tij në lidhje me autorizimin për të marrë borxh. Ligji për buxhetin përcakton kufirin sa do të merret borxh, por nuk tregon kushtet dhe mënyrat në të cilat do të merret borxh. Po të ishte kaq e thjeshtë sa arrihet të përcillet nga ana e propozuesve të ligjit, atëherë togfjalëshi ***'kur***

autorizohet me ligj do të ishte zëvendësuar me togfjalëshin **'kur autorizohet me ligj, referuar buxhetit të shtetit'**. Neni 156 i Kushtetutës kur flet për autorizimin me ligj, nuk i referohet vetëm kufirit sasior të vendosur në buxhetin e miratuar nga Kuvendi, por ka parasysh edhe kushtet dhe mënyrat e marrjes së borxhit qoftë të brendshëm apo të jashtëm.

Rezulton, që Kuvendi në asnjë rast nuk ka vendosur kushte të përgjithshme të cilave do t'i referohet Ministri i Financave në marrjen e borxhit. As ndryshimet ligjore nuk e kanë përmbushur një gjë të tillë.

Propozuesit e ligjit dhe Komisionet përkatëse kanë vërejtur se problemi qëndron në lidhje me monitorimin/kontrollin *ad hoc* nga ana e Kuvendit në lidhje me marrjen e borxhit të jashtëm nga subjekte private, në kushtet e mungesës së kriterëve ligjore për negocimin dhe marrjen e borxhit.

Në fakt është e gabuar ndarja e borxhit të brendshëm nga ai i jashtëm, apo borxhi nga Shtete/organizata ndërkombëtare apo subjekte private të huaja. Kuvendi e ushtron pushtetin e tij që në momentin që autorizon marrjen e borxhit, duke përcaktuar qartë edhe kushtet dhe mënyrat e marrjes të atij borxhi. Diskutimi nëse duhet ratifikuar apo jo me vonë në Parlament referuar nenit 121 të Kushtetutës, ky është një diskutim tjetër, i cili vjen më pas në kohë. Autorizimi i kërkuar nga ligji nuk ka lidhje me ratifikimin e një marrëveshje me një subjekt të huaj huadhënës qoftë ky publik apo privat.

Edhe propozuesit e ligjit kanë pranuar se mungojnë rregullime ligjore për negocimin dhe marrjen e borxhit, por më pas kanë ngatërruar autorizimin që kërkohet nga 156 me ratifikimin që kërkohet nga 121/1/ç e Kushtetutës. Veç të tjerash, Komisioni i Ekonomisë në Raportin e tij ka sqaruar se pavarësisht miratimit paraprak të kufirit të borxhit në rastin e miratimit të buxhetit, duhet të bëhet pjesë e ligjit të buxhetit edhe shuma e shpenzimeve për interesa.

Pra, është e qartë që në praktikën aktuale dhe me rregullimet ligjore të bëra, jo vetëm që Kuvendi nuk ka përcaktuar në mënyrë të plotë kufirin sasior, duke përfshirë edhe shumën e shpenzimeve për interesa, por as nuk ka miratuar paraprakisht me ligj kushtet dhe mënyrën e marrjes së borxhit dhe dhënies së garancive.

Në përmbushje të detyrimit Kushtetues, që borxhi duhet të autorizohet me ligj, do të ishte e nevojshme që kjo të bëhej rast pas rasti, apo në ligjin në shqyrtim të vendoseshin rregullime ligjore të qarta, të cilat tregojnë kushtet dhe mënyrat e marrjes së borxhit, duke përfshirë momentin e kërimit, negocimit dhe deri në lidhjen dhe ekzekutimin e kontratës.

Jam plotësisht dakord, që detyrim kushtetues është që borxhi të merret me një kosto sa më të ulët, por kjo nuk do të thotë që pushtetin që ka parlamenti për të autorizuar marrjen e borxhit dhe për të vendosur në lidhje kushtet dhe mënyrat e marrjes së borxhit t'ia delegojë në mënyrë absolute qeverisë dhe të mjaftohet me raportimin që bën Ministri i Financave një herë në 4 muaj në Komisionin e Ekonomisë.

Vlerësoj se në emër të fleksibilitetit të Ministrit të Financave dhe të uljes së kostonë së borxhit nuk mund të çenohet parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe as të çenohen dispozitat kushtetuese të cilat kanë përcaktuar qartë **se kufiri, kushtet dhe marrjes së borxhit të brendshëm apo të jashtëm do të vendosen vetëm nga Kuvendi**. Pra, në rastin konkret të ndryshimeve ligjore, jo vetëm nuk ekziston një përjasje me standartet ndërkombëtare siç pretendohet, por është prekur në mënyrë të qartë pushteti i Kuvendit i njohur në Kushtetutë.

Së Treti: Në kuptim të Kushtetutës, borxhi shtetëror duhet të trajtohet në mënyrë transparente përsa kohë bëhet fjalë për Financa Publike. Vërej se dispozitat në ligjin 181/2014 nuk e ofrojnë dicka të tillë dhe për më tepër bëjnë të qartë një pushtet të pakufizuar dhe aspak transparent të ekzekutivit në procesin e marrjes së borxhit.

Në nenin 6 të ligjit nr. 181/2014, është parashikuar ndryshim në nenin 26 të ligjit ekzistues, ku përcaktohet se në rastin e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, Ministri i Financave duhet të përmbushë kushtet e përcaktuara në ligjin e buxhetit. Në fakt ligji i buxhetit përcakton kufirin e borxhit dhe nuk përmban kushte specifike dhe mënyrat e negocimit dhe marrjes së borxhit, kjo është pranuar edhe nga vetë propozuesit në Relacionin e projekt-ligjit. Për t'i shërbyer qëllimit të ligjit, duhej të ishin përcaktuar qartë linjat kryesore mbi bazën e të cilave Ministri i Financave kërkon, negocion apo lidh marrëveshjet e borxhit.

Neni 6 përcakton se në rast të kalimit të kufirit të borxhit duhet të merret miratimi paraprakisht në Parlament. Por nga ana tjetër neni 4 i ligjit përcakton se: *'Tejkalimi i kufizimeve, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, nuk mund të çënojë palët e treta (huadhënësit ose mbajtësit e titujve të shtetit, si dhe personat, në favor të të cilëve shteti ka dhënë garanci shtetërore) dhe në asnjë rast nuk sjell si pasojë pavlefshmërinë e marrëveshjeve përkatëse të huamarrjes apo lëshimit të garancive shtetërore'*.

Pra duket qartë, se ekzistojnë raste që Ministri i Financave do të marrë borxh edhe duke kapërcyer kufirin sasior të vendosur nga Kuvendi dhe në këto raste marrëveshjet me palët e treta do të jenë plotësisht të vlefshme, duke e vënë në këtë mënyrë R.SH-së para detyrimeve financiare të pakontestueshme. Në këtë rast kontrolli post marrëveshje nga ana e Kuvendit do të ishte formal, pasi borxhi ishte marrë edhe në kushtet që në rast të kapërcimit të kufirit sasior duhej marrë miratim paraprak nga Kuvendi. Pra sërish, duket një pushtet pa kufi i Ministrit të Financave i cili është tashmë absolut karshi pushtetit të Kuvendit që autorizon marrjen e borxhit referuar nenit 156 të Kushtetutës.

Në nenin 6 të ligjit 181/2014 ashtu edhe në të tjera, ligji referon në instrumentet financiare përmes të cilëve do të realizohet huamarrja nga Ministri i Financave. Nuk ekziston asnjë përkufizim i instrumenteve financiare që do përdoren nga Ministri i Financave, gjë që vë në dyshim edhe procesin e marrjes së borxhit, i cili pretendohet të realizohet pa u autorizuar dhe miratuar nga ana e Kuvendit. Ky shqetësim është përcjellë edhe nga ana e Komisionit të Ligjeve në Raportin e tij, të cilët i kanë kujtuar Këshillit të Ministrave se ligji duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë në mënyrë që nesër të mos krijojë mundësi për keqinterpretime.

Ndryshime të tjera, të cilat vënë në dyshim transparencën e këtij procesi dhe tregojnë për pushtetin diskrecionar të ekzekutivit janë edhe në drejtim të përzgjedhjes së subjektit privat kreditor, të këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të borxhit shtetëror.

Në radhë të parë nuk bëhet një përkufizim i këshilltarëve apo ndërmjetësve të borxhit shtetëror dhe as përcaktohen në ligj kompetencat e tyre, ashtu siç janë të përcaktuara për agjentët fiskalë në nenin 31/ para2 i ligjit ekzistues.

Në radhë të dytë, përmes nenit 10 të ligjit është ndryshuar paragrafi i parë i ligjit ekzistues në lidhje me përzgjedhjen e këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të marrjes së borxhit, duke i përjashtuar nga rregullat e prokurimit publik referuar nenit 7/ç të ligjit nr. 9643/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Relacioni i projekt ligjit e justifikon një rregullim të tillë referuar nenit 7/ç, gjë e cila nuk është e përcaktuar në mënyrë të qartë dhe nuk duket të jetë rasti. Në këto kushte, përjashtimi duhej të ishte bërë në ligjin 9643/2006, i ndryshuar.

Në radhë të tretë, përmes nenit 6 përcaktohet përzgjedhja me VKM e subjekteve private kreditore të huaja apo vendase. Në asnjë rast, neni 7/ç nuk i ka përjashtuar këto raste nga zbatimi i procedurave të prokurimit publik.

Për t'i shërbyer shpejtësisë së procedurave në kredimarrje, propozuesit mund të bënin përjashtimet në mënyrë të qartë në ligjin nr. 9643/2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në nenin 7 duke përcaktuar qartë rastet, duke u zbatuar në këtë mënyrë parimi i 'lex specialis', gjë e cila është kërkuar edhe nga Komisioni i Ligjeve. Por, në çdo rast për t'i shërbyer transparencës në marrjen e borxhit dhe për t'i shërbyer zbatimit të nenit 156 të Kushtetutës, këto procedura të përzgjedhjes së kreditorëve private, agjentëve fiskalë, ndërmjetëve etj duhet të ishin aprovuar paraprakisht nga Kuvendi. Në kushtet e fleksibilitetit të veprimit dhe pretendimit të mosautorizimit rast pas rasti siç e kërkon Kushtetuta, rregullime të tilla do të duhej të bëheshin me ligj.

Të gjitha ndryshimet sa më sipër, tregojnë një diskrecion të ekzekutivit për të vendosur për mënyrat dhe kushtet e marrjes së borxhit, në përzgjedhjen e kreditorit subjekt privat, këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetëve, gjë e cila tregon një mungesë të plotë transparence në menaxhimin e borxhit dhe të fondeve publike dhe sërish për një cënim të pushtetit të Kuvendit të përcaktuar në Kushtetutë.

Së Katërti: Në nenin 6 dhe 7 të ligjit bëhen ndryshime në procedurat në lidhje me procedurat për nënshkrimin e marrëveshjeve dhe ratifikimit të atyre që konsiderohen ndërkombëtare. Vihet re se propozuesit e ligjit kanë bërë një ndarje të marrëveshjeve ndërkombëtare në referim të nenit 121/1 të Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në referim të nenit 121/3 të Kushtetutës, duke e lidhur këtë me detyrueshmërinë e ratifikimit ose jo të marrëveshjes së borxhit në Kuvend.

Doktrina ka përcaktuar qartë se çfarë rregullon e drejta ndërkombëtare publike dhe çfarë rregullon e drejta ndërkombëtare private.

Ajo çfarë e ngarkon këtë diskutim, i cili ka rezultuar në produktin final që është ligji aktual në shqyrtim, është pikërisht ndarja që bëhet mes nenit 121 dhe 156 të Kushtetutës. Vihet re që i kushtohet një rëndësi e madhe faktit nëse subjekti kreditor është Shtet, Organizatë Ndërkombëtare apo Subjekt privat i huaj/vendas.

Në secilin nga rastet, ajo çfarë kërkohet nga ana e Kushtetutës është autorizimi nga Kuvendi për kufirin, kushtet dhe mënyrat e marrjes së borxhit, të cilat nuk mund të delegohen në mënyrë absolute tek ekzekutivi, ashtu siç edhe janë rregulluar përmes ligjit në shqyrtim.

Neni 121 i Kushtetutës i referohet Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe nuk ka lidhje me marrëdhëniet juridike private me elementë të huaj. Nuk mund të ketë ndarje në Marrëveshje Ndërkombëtare të Huas me Shtet/Organizatë Ndërkombëtare dhe Marrëveshje Ndërkombëtare me subjekte të huaja private.

Miratimi në Parlament i Marrëveshjeve të tilla të Huas është i detyruar, pavarësisht nëse kreditori është Shtet, Organizatë Ndërkombëtare apo subjekt privat i huaj, përsa kohë Kuvendi do të kontrollojë edhe kushtet specifike të marrëveshjes së realizuar e cila sjell edhe detyrime financiare për shtetin.

Një nga kushtet e marrëveshjes së huave referuar praktikave të mëparshme ka qenë Imuniteti i shteteve apo pasurive të tyre ndaj juridiksionit të një shteti tjetër, i cili është një parim i pranuar gjerësisht nga e drejta ndërkombëtare zakonore dhe është pjesë e diskutimeve të marrëveshjeve të huas në kuadrin e garancive të dhëna.

Imuniteti është shprehje e sovranitetit të një shteti dhe mund të vendoset nga ana e Kuvendi. Në asnjë rast nuk mund t'i lihet pushtet absolut ekzekutivit në këtë drejtim përsa kohë negociacion dhe nënshkruan marrëveshje të tilla, duke lënë garanci dhe pranuar kushte të cilat do

të ishin të papranueshme nën optikën e Kuvendit të Shqipërisë, si autoriteti i caktuar me Kushtetutë për të autorizuar marrjen e borxhit dhe përcaktuar kushtet dhe mënyrën e marrjes së tij.

Edhe pasuria e shtetit shqiptar për shkak të parimit të sovranitetit të shtetit gëzon imunitet. Pasuritë shtetërore publike nuk mund të shërbejnë si garanci në marrëveshjet e marrjes së borxhit, pasi kjo do të ishte me pasoja fatale për Shtetin.


Një çështje tjetër është pozita e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë në përmbushje të traktateve, konventave apo marrëveshjeve ndërkombëtare. Neni 26 i Konventës së Vjenës “Për ligjin e traktateve” (Law of Treaties) parashikon se “çdo traktat në fuqi është i detyrueshëm për palët dhe duhet zbatuar në mirëbesim prej tyre”. Ky parim gjen shprehje pak a shumë edhe në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila parashikon se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Burime të kësaj të drejte siç dihet janë edhe traktatet, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Në këto kushte, Republika e Shqipërisë si subjekt i së drejtës publike ndërkombëtare përmbush detyrime dhe realizon të ardhura (ndër të cilat edhe të ardhura monetare), të cilat kurrsesi nuk mund të jenë të sekuestrueshme apo të ekzekutueshme. Këto të ardhura destinohen për qëllime publike. Një veprim i kundërt do të pengonte realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar (si subjekt i së drejtës ndërkombëtare publike) në kuadër të trakteve, konventave apo marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat është palë. Rrjedhimisht, shteti shqiptar nuk do të ishte në gjendje të përmbushte detyrimet ndërkombëtare.

Referuar sa më sipër, është e qartë se në çdo rast të marrjes së borxhit të brendshëm apo të jashtëm, referuar kufirit, kushteve dhe mënyrës së marrjes së borxhit duhet të merret miratimi nga Kuvendi, ndërsa përsa i përket respektimit të Konventës së Vjenës “Për Ligjin e Traktateve”, dispozitat e saj janë të vlefshme për të gjitha marrëveshjet mes shteteve, shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, por nuk mund përjashtohet mundësia të aplikohen dhe në marrëveshje të tjera ndërkombëtare. Rregullimet ligjore në ligjin 181/2014 janë rezultat i një interpretim të gabuar të neneve 121, 156 dhe 159 të Kushtetutës dhe si rezultat përbëjnë një cënim të rëndë të saj dhe të parimeve të saj.

Të nderuar deputetë,

Në përfundim, referuar sa më sipër kërkoj mirëkuptimin Tuaj në rishqyrtimin e ligjit nr.181/2014 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”’, pasi nuk justifikon qëllimin për të cilin është hartuar dhe për më tepër bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Me respekt,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

BUJAR NISHANI